UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 864
Datë: 14/4/2023

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 17, paragrafi 3, dhe nenit 23, të cilat ndërlidhen me kërkimet shkencore dhe dijen, të përcaktuara me nenet 164 deri në 167 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2023, miratoi:

RREGULLOREN

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 3/879, të datës 11.12.2020, për financimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore, artistike dhe sportive në Universitetin e Prishtinës

Neni 1
Qëllimi dhe përkufizimet

1. Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 3/879, të datës 11.12.2020, për financimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore, artistike dhe sportive në Universitetin e Prishtinës.

2. Përkufizimet në kuadër të kësaj rregulloreje mbesin të njëjta siç janë përcaktuar në Rregulloren me nr. prot. 3/879, të datës 11.12.2020, për financimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore, artistike dhe sportive në Universitetin e Prishtinës.

Neni 2

Paragrafi 2 i nenit 8 [Ndarja e fondeve] të rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

2. Financimi i publikimit të punimeve shkencore (grupi 1, grupi 2 dhe grupi 3) është në vlerë fikse dhe rimbursohet pas paraqitjes së kërkesës, duke u siguruar që autorësia e punimit lidhet me adresën e Universitetit të Prishtinës. Mbështetja financiare e siguruar nga universiteti apo njësitë akademike mund të përdoret më shumë se një herë në vit, pavarësisht nga burimi financiar, nëse publikimi është realizuar në revista shkencore të mbuluara nga *Clarivate Analytics – Web of Science*. Punimeve/publikimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës nuk mund t'u ofrohet mbështetje për autorët e njëjtë, të cilët kalojnë më tepër se tri (3) punime në vit. Përveç kësaj, shuma e mbështetjes që do të jepet nga PNPSH-ja për publikimet shkencore të grupeve 2 dhe 3 nuk mund të tejkalojë dyfishin e shumës së përshkruar për grupin 1 (SCIE; SSCI; AHCI). Shuma e cila ndahet për këto aktivitete nuk kalon 55 % të buxhetit total të ndarë për PNPSH-ja (Tabela 1).

Neni 3

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 9 [Skema e financimit dhe stimujt financiarë] të rregullores bazike, riformulohen si në vijim:

2. Përjashtimisht aktiviteteve të parapara në nenet 6 dhe 7 të rregullores, buxheti i paraparë për financimin e punimeve shkencore, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, alokohet sipas numrit të personelit të rregullt akademik në njësi akademike. Në rast të mosshfrytëzimit të mjeteve të planifikuara, ato rishikohen në gjysmën e dytë të vitit përkatës dhe të njëjtat mjete ridestinohen, varësisht suksesit të arritur në publikime, duke iu dhënë prioritet punimeve në grupin 1.

3. Skema e financimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqitet sipas tabelave 1-3, me sa vijon:

Tabela 1. Publikimet shkencore në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Gr. 1 (neni 5.1.1)	Shuma	Punime për vit*
Shkenca të Natyrës/Teknike Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.	SCIE, SSCI, AHCI	€ 1,000.00	deri në 3
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	SCIE, SSCI, AHCI	€ 900.00	deri në 3
Fusha	**Gr. 2 (neni 5.1.2)**	**Shuma**	**Punime për vit**
Shkenca të Natyrës/Teknike Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.	Scopus (Q1) Scopus (Q2)	€ 600.00 € 500.00	deri në 3
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	Scopus (Q1) Scopus (Q2)	€ 500.00 € 400.00	deri në 3
Shkenca të Natyrës/Teknike Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.	Scopus (Q3) Scopus (Q4)	€ 400.00 € 300.00	deri në 3
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	Scopus (Q3) Scopus (Q4)	€ 300.00 € 200.00	deri në 3
Fusha	**Gr. 3 (neni 5.1.3)**	**Shuma**	**Punime për vit**
Të ndryshme	*Shtëpitë botuese*	€ 600.00 (libër) € 200.00 (kapituj)	deri në 2

**Nënkupton punime nga një autor apo grup autorësh të fushave përkatëse.*

Tabela 2. Pjesëmarrja në aktivitete shkencore/artistike në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Grupi A	Shuma	Aktivitete**
Gjithëpërfshirëse, personeli akademik dhe studentët e doktoratës.	Pjesëmarrësit si prezantues i punimit, folës, panelist, kryesues seksioni, etj.	€ 600.00	Konferenca, simpoziume, ekspozita, etj.
	Grupi B	**Shuma**	
	Pjesëmarrësit si shoqërues pa prezantim, etj.	€ 300.00	

Tabela 3. Projektet shkencore/hulumtuese në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Thirrja e UP-së	Shuma	Projekte për vit***
Të gjitha fushat	**Shkurt - mars** dhe **korrik - gusht**	€ 0.00 – € 25,000.00	deri në 2 projekte për njësi akademike (brenda buxhetit)

Neni 4

Nënparagrafi 1.2 i paragrafit 1 të nenit 10 [Procedurat dhe parashtrimi i kërkesës për financimin e publikimeve shkencore dhe vlerësimi] të rregullores bazike riformulohet si në vijim:

1.2. Në një vit, personeli akademik që ka realizuar botime deri tri (3) herë në vit, siç përcaktohet në grupin 1 dhe grupin 2, ka të drejtë për mbështetje financiare pa një vendim të KD-së të universitetit, ndërsa për punimet të cilat kategorizohen në grupin 3 mund të kenë të drejtë për mbështetje financiare vetëm një (1) herë në vit pa një vendim të KD-së të universitetit.

Nën-nënparagrafët prej 1.3.2 deri në 1.3.6 të nenit 10 [Procedurat dhe parashtrimi i kërkesës për financimin e publikimeve shkencore dhe vlerësimi] të rregullores bazike fshihen tërësisht.

Neni 5

Me termin staf akademik, të përdorur në këtë rregullore, nënkuptohet vetëm stafi akademik në marrëdhënie të rregullt punë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Neni 6
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja me nr. prot. 1/16, e datës 10.6.2021, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 3/879, të datës 11.12.2020, për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe sportive në Universitetin e Prishtinës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" 1970 UNIVERSITY OF PRISHTINA

Altin Sahiti

Kryesues i Keshillit Drejtues